

Dr. Hafsa Fidan

GRUAJA NË NJË BOTË QË PO NDRYSHON

Titulli origjinal:
Değişen dünyada kadın

Nga turqishtja:
Rehan Neziri

Kreuzlingen, 2024

Përmbajtja:

Hyrje	4
Gruaja në rrugën e të qenit individ.....	13
Vajzat në kthetrat e paragjykimeve	18
Identitete të reja, përgjegjësi të reja dhe gruaja si bashkëshorte.....	25
Kur gruaja bëhet nënë.....	29
Gruaja si objekt dhe si subjekt i dhunës	33
Gruaja midis traditave dhe vlerave bashkëkohore.....	40
Arsimimi dhe gruaja	45
Vlerat universale dhe gruaja	47

Hyrje

Kur thuhet “grua” ose „femër“, mendja të shkon te vajza, motra, nëna, gruaja dhe, mbi të gjitha, te një individ i shoqërisë; dhe rolet e të qenit grua shfaqen në të gjitha këto fusha.

Statusi i gruas, gjatë historisë, ka përjetuar pamje të llojllojshme në struktura të ndryshme shoqërore. Në historinë e pranuar gjerësisht, supozohet se njerëzimi “përparon” përgjatë një linje të drejtë. Brenda kësaj kornize, supozohet se edhe gratë “përparojnë” në rolet që u ndahen atyre. Megjithatë, kjo qasje e përgjithësuar e injoron faktin se historia ka epoka të ndryshme brenda saj. Me fjalë të tjera, në realitet “ka epoka brenda epokave.”

Të ketë epoka brenda epokave do të thotë që brenda historisë ka grupe njerëzish që historinë e jetojnë ndryshe. Gjatë historisë, gratë, në vende të ndryshme, ndonjëherë edhe në të njëjtën gjeografi, janë shfaqur në shtresa dhe në role të ndryshme

sociale. Gratë në të kaluarën kanë qenë amvisa, bujkësja që punonin arat, tregtare ose mbretëresha; të gjitha këto forma të ndryshme të pozitës së saj në shoqëri. Edhe sot, gratë marrin pjesë në jetën sociale dhe ekonomike në role të shumta, nga amvisa e deri te presidente shteti. Pa dyshim, në përgjithësi mund të thuhet se në kohët tona, gratë, në mënyrë më aktive marrin pjesë në jetën socio-ekonomike, se në jetën e tyre profesionale ato marrin përsipër edhe role që në shoqëritë tradicionale ishin të rezervuara vetëm për burrat dhe në këtë kuptim ato e kanë zgjeruar fushëveprimin e rolit të tyre si grua. Megjithatë, është e pamundur të thuhet që çdo shoqëri ndjek të njëjtin kurs. Prandaj, mund të thuhet se në kohët tona, ka komunitete grash që historinë e përjetojnë ndryshe nga gratë në vende e gjeografi të tjera.

Edhe problemet e grave, që historinë e përjetojnë brenda kushteve të tyre specifike, janë të larmishme, varësisht nga kushtet sociale dhe kulturore, nga shtresa ekonomike, nga niveli i arsimit që kanë ato etj. Për shembull, ka

dallime prioriteti të problemeve të grave që punojnë në bujqësi dhe që jetojnë në fshat nga ato të grave që punojnë në sektorin publik dhe që jetojnë në qytet. Sipas kësaj, edhe për zgjidhjen e këtyre problemeve duhet zhvilluar mendime të ndryshme. Në mënyrë të ngjashme, edhe problemet e grave që jetojnë në qytet, kur të shikohen nga kriteri i të qenit të saj amvise, e punësuar apo e arsimuar, do të na dalin të llojllojshme.

Në çdo shoqëri dhe kulturë, është rrethi social ai që i formëson rolet e femrës dhe të mashkullit brenda vetvetes. Këto role nuk shfaqen kuturu vetëm nën emrin e roleve të femrës dhe të mashkullit, por gjithashtu formojnë edhe kallëpe ose struktura të brendshme shoqërore të ndërlidhura me njëra-tjetrën, në formën e rolit të bijës, birit, vajzës së re, djalit të ri, nuses, dhëndrit, vjehrrës, vjehrrit etj. Çdo strukturë shoqërore duhet të kuptohet si koherente ose të paktën si “funktionale” brenda saj.

Në formimin dhe vazhdimësinë e strukturës shoqërore, elementet ekonomike, politike, juridike, fetare dhe

zakonore veprojnë bashkë duke shkaktuar një ndikim të përbashkët.

Për të vlerësuar rolet që u vishen grave në një shoqëri, është e nevojshme të merret parasysh prania e elementeve specifike të asaj shoqërie. Gjithashtu, në ndarjen e roleve midis grave dhe burrave, ndikim kanë edhe elemente të tjera siç janë cilësitë që përvetësohen nëpërmjet komunikimit dhe ndërveprimit me komunitetet e tjera. Pa dyshim, asnjë shoqëri nuk mund të ekzistojë si një kuti e mbyllur plotësisht në vetvete. Tradita, gjuha, feja, kultura dhe faktorët e tjerë që kanë ndikim në strukturën shoqërore ndryshojnë vetë gjatë historisë duke u interpretuar, me çka shkaktojnë ndryshim edhe në shoqëri. Mu ashtu siç janë dinamike elementet që ne i quajmë traditë, gjuhë, fe dhe kulturë, si dhe strukturat mbi të cilat këto elemente ushtrojnë ndikim, edhe rolet e grave dhe burrave janë po ashtu dinamike.

Në vendin tonë (në Turqi), veçanërisht gjatë dy shekujve të fundit të periudhës së modernizimit, rolet e grave dhe burrave janë bërë objekt debatesh

dhe polemikash. Botëkuptimi modernist, që e sheh të domosdoshme orientimin e vendit drejt Perëndimit dhe vazhdimin e këtij procesi, ka fajësuar traditat dhe fenë për problemet në organizimin e grave dhe familjes. Ndërsa ajo që e përbën polin tjetër në këto debate e polemika dhe që e përfaqëson botëkuptimin tradicionalist, për këtë i ka fajësuar përpjekjet perëndimizuuese dhe vetë procesin e modernizimit. Në këtë situatë, disa mendimtarë e shohin burimin e problemit në largimin nga vlerat tradicionale, ndërsa të tjerët e shohin në lidhjen e tepruar me këto vlera, që nuk lejojnë përvojën e modernizimit.

Në këtë polarizim, ku pranohet një kundërshti e theksuar midis traditës dhe modernitetit, duket se problemi themelor është vetë “teza e kundërshtimit”. Me fjalë më të qarta, problemi qëndron në përvetësimin e tezës së kundërshtimit të fortë midis traditës dhe modernitetit. Me këtë rast, edhe kur dikush e pozicionon veten në kampin modern dhe shprehet se është kundër traditës, në realitet, ai

ende vepron brenda asaj tradite kundër së cilës thotë se është.

Të mendosh se tradita gjithmonë i kundërvihet modernes dhe se ajo vetë mbetet e pandryshueshme, është një lloj iluzioni. Sepse tradita, për të mbetur traditë, ajo ka nevojë të përsëritet dhe të përtërihet vazhdimisht. Me fjalë të tjera, tradita është në çdo rast dinamike. Vetëm se, dinamizmi i traditës mund të jetë më i shpejtë në disa shoqëri dhe më i ngadalshëm në disa të tjera. Prandaj, edhe pse në një gjuhë të thjeshtë mund të bëhet konceptualizimi në „tradicionale“ dhe „moderne“, teza e ndarjes dhe e kundërshtimit të fortë midis këtyre të dyjave është problematike, pasi e injoron „spiralën e së vjetrës dhe të resë, të tradicionales dhe modernes“.

Feja, të cilën botëkuptimet moderniste e shohin si një element pengues, në dyzimin „tradicionale“ dhe „moderne“, nuk mund të pozicionohet qartë në favor të njërës palë. Feja dhe vlerat që rrjedhin nga burimet fetare ndihmojnë në formësimin e asaj që quhet tradicionale, por njëherazi ato e kritikojnë atë dhe nganjëherë edhe i

kundërvihen. Po ashtu, feja ofron mundësi për të siguruar formësimin e asaj që quhet moderne. Në këtë mënyrë, ajo luan rolin e pasqyrës në identifikimin e pikave ku e reja mund të shfaqet si alternativë ndaj së vjetrës. Supozimi se feja qëndron përballë të resë dhe modernes, buron nga mungesa e njohjes së funksionit të saj (fesë) si një burim që lejon interpretime të reja.

Ndërkaq feja, në thelb, i tregon rezistencë traditës që nuk mund të arsyetohet. Në këtë kontekst, feja është në një pozicion përsipër, kur është në pyetje lufta ndërmjet modernes dhe tradicionales. Feja dhe vlerat e prodhuara nga feja, duke e mbështetur nga njëra anë modernen, ndërsa nga ana tjetër traditën, në horizontin e ngjizjes së të kaluarës me të ardhmen, i japin formë së tashmes.

Tematika e roleve që gratë duhet të kenë në organizimin shoqëror dhe familjar ka qenë një pikë e nxehtë debati mes mbështetësve të tradicionales dhe atyre të modernes. Në ndërkohë që në vendin tonë vazhdojnë diskutimet që nga periudha e Tanzimatit e

kënde, njëkohësisht po bëhen edhe rregullime ligjore për të drejtat e grave, për edukimin e tyre dhe për detyrat që ato mund të ushtrojnë në fushat sociale dhe politike. Rregullimet që janë bërë në lidhje me të drejtat e grave që nga periudha e Tanzimatit janë renditur në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Statusit të Grave si më poshtë:

Në vitin 1843, në kuadër të shkollës mjekësore, gratë filluan të marrin arsim për mami. Më 1847 u shpall një dekret që u njihte të drejta të barabarta në trashëgimi fëmijëve vajza dhe djem. Më 1856 u ndalua shitblerja e skllëverve dhe e robërshave. Më 1858 në Kodin për Tokën u përcaktua se trashëgimia do të ndahej në mënyrë të barabartë midis vajzave dhe djemve. Kështu, gratë fituan për herë të parë të drejtën e pronësisë nëpërmjet trashëgimisë. Më 1858 u hapën shkollat e mesme për vajzat. Më 1869 u botua revista "Teraki-i Muhadderat", e cila njihet si botimi i parë i vazhdueshëm për gratë (javore). Më 1869 u shpall një rregullore e cila për herë të parë e bënte detyrim ligjor

arsimimin publik të vajzave. Më 1870 u themelua shkolla për mësuese, Darul Muallimat. Më 1871, me Dekretin e Kodit Familjar, që u nxor për ta zbatuar Mexhelen (Kodin Civil Osman), u rregullua që kontrata e martesës të bëhej në prani të ofiqarit zyrtar, që mosha e martesës për djemtë të ishte 18 dhe për vajzat 17 vjet, dhe që martesat e dhunshme të shpalleshin të pavlefshme. Më 1876 u miratua Kushtetuta e parë (Kanuni Esâsi) që rregullonte të drejtat themelore të njeriut. U bë i detyrueshëm edhe arsimimi fillor për vajzat dhe djemtë. Më 1897 gratë filluan të punojnë si punëtore me pagë. Më 1913 gratë filluan të punojnë për herë të parë si punonjëse shtetërore. Më 1914 u hap një institucion i arsimit të lartë për vajzat me emrin "İnas Darülfünunu". Më 17 shkurt 1926 u miratua Kodi Civil Turk. Me këtë kod u hoqën rregullimet për martesën e burrit me më shumë gra dhe për divorcin e njëanshëm nga ana e burrit, u njoh e drejta e grave për divorc, për kujdestari dhe për të disponuar pasuri private. Më 1930 u miratua Ligji i

Bashkive. Me këtë ligj, grave iu dha e drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet lokale, komunale. Më 5 dhjetor 1934, me ndryshimin e Kushtetutës, grave iu dha e drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur në të gjitha nivelet.

Sot është e njohur se gratë tanimë janë aktive në jetën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Kjo situatë gjithashtu po ndryshon në një masë të caktuar edhe rolet e grave dhe burrave brenda shtëpisë. Sepse, duke qenë se, në thelb, rolet e grave dhe burrave janë dinamike, kjo nënkupton se këto role janë të hapura për ndryshime të ndërsjella.

Gruaja në rrugën e të qenit individ

Koncepti i individit, si një term psikologjik, nënkupton “qenien e vetme, individin, që përbën grupin njerëzor, që në vetvete mbart tipare të ngjashme me njerëzit e tjerë, por që gjithashtu zotëron edhe karakteristika të veçanta dhe dalluese”; ndërsa si një term sociologjik, nënkupton “çdo individ që

përbën shoqërinë dhe që ka cilësi mendore, emocionale dhe të vullnetit, të cilat përcaktohen brenda shoqërisë”. (Fjalori i *Türk Dil Kurumu*)

Feja jonë pranon se çdo njeri është përgjegjës për besimin, sjelljet dhe adhurimet e tij dhe, në këtë kuptim, secili njeri është një “individ”. Ashtu siç u jep njerëzve lirinë në zgjedhjet e tyre, i mban ata përgjegjës për çdo rezultat të zgjedhjeve të tyre, që kanë të bëjnë qoftë me këtë botë, qoftë me botën e përtejme.

“Qoftë burrë apo grua, kushdo që bën vepra të mira si besimtar, patjetër që do t’i bëjmë të jetojnë një jetë të këndshme (në këtë botë) dhe do t’i shpërblejmë (në botën tjetër) me më të mirën e veprave që kanë bërë.” (en-Nahl, 16:97)

“Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre (e tha): ‘Unë nuk ia humbas veprën asnjë punëtori nga ju, qoftë mashkull apo femër...’” (Alu Imran, 3:195)

Koncepti i individit ndonjëherë lidhet me terma që kanë konotacionin e “egoizmit”. Megjithatë, kur mendojmë sipas parimeve morale të Islamit, nuk është e mundur ta kuptojmë

individualizmin si egoizëm. Sepse feja Islame, në përpjekjen e saj për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të rehatshme, e konsideron çdo person, qoftë grua apo burrë, përgjegjës për rrethin e tij. Sipas moralit islam, jo vetëm që nuk pranohet filozofia e të jetuarit vetëm për veten, por përkundrazi, kërkohet e kundërta: të japësh nga ajo që e do, të ndash atë që e zotëron është një virtyt. Për më tepër, egoizmi, kryelartësia dhe vetëpëlqimi nuk miratohen në moralin islam.

Individualiteti, në kuptimin e zhvillimit të vetëdijes, nuk bie ndesh me konceptin moral të Islamit. Vetëdija nuk realizohet vetëm duke u nisur nga vetvetja; ajo kërkon që njeriu ta kuptojë veten dhe universin në një rrjet të ndërlidhur marrëdhëniesh. Sipas vizionit islam për njeriun, ai duhet ta njohë veten, universin dhe krijesat e tjera, dhe të jetë i vetëdijshëm se jeton brenda një tërësie. Në këtë kontekst, gruaja dhe burri janë pjesë e tërësisë së universit. Në jetën shoqërore, gruaja dhe burri janë mbrojtës dhe miq të njëri-tjetrit, vëllezër dhe motra. (et-

Teube, 9:71) Për këtë arsye, prej tyre pritet të jenë njerëz bashkëpunues, bamirës, me një ndjenjë të zhvilluar të përgjegjësisë dhe të ndjeshëm ndaj rrethit të tyre. Elemente të tilla si respektimi i të drejtave të fqinjëve, vizitat e të sëmurëve dhe ndihma ndaj njëritjetrit në ditë të vështira, të cilat e forcojnë jetën shoqërore dhe të cilat promovohen nga feja jonë, e parandalojnë keqkuptimin e individualitetit si “egoizëm”. Këto na shtyjnë ta shohim gruan dhe burrin si individë të përgjegjshëm, të vetëdijshëm për veten dhe për universin ku jetojnë.

Në Kur'an, besimtarët dhe besimtarët përmenden krah për krah për çështje të besimit, moralit, adhurimit, si dhe për punët që lidhen me sferat sociale dhe ekonomike:

„Nuk ka dyshim se për muslimanët e muslimanet, besimtarët e besimtarët, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit dhe të sinqertat, durimtarët dhe durimtarët, të përulurit dhe të përulurats, sadakadhënësit dhe sadakadhënëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, shumë përmendësit e Allahut e shumë

përmendëset e Allahut, Allahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpërblim të madh.” (el-Ahzab, 33:35)

Sipas këtyre ajeteve, gratë kanë shumë përgjegjësi të ndryshme, si të japin zekat dhe sadaka nga pasuria e tyre për të mirën e shoqërisë, të ndihmojnë të varfrit duke shpresuar shpërblim nga Allahu, të jenë të sinqerta dhe të drejta në veprimet e tyre, dhe të tregojnë respekt të thellë ndaj Allahut. Ky përshtkrim tregon se si gratë dhe burrat duhet të ndajnë në mënyrë të ngjashme përgjegjësitë që sjell jeta.

Në fenë tonë, njeriu shihet si një individ i lirë dhe njëkohësisht i përgjegjshëm. Të qenit “individ” për gratë dhe burrat do të thotë ta kuptojnë kornizën e lirisë dhe të përgjegjësive të tyre. Kjo do të thotë që ideja e lirisë nuk duhet të çojë në papërgjegjshmëri, ndërsa ideja e përgjegjësive nuk duhet të kthehet në skllavëri.

Vajzat në kthetrat e paragjytimeve

Sipas besimeve tradicionale, bindja se prejardhja familjare vazhdohet nëpërmjet djemve, në shumë familje e mban gjallë dëshirën e fortë për të pasur domosdo një djalë. Kjo dëshirë për të pasur djem, përsëri besimit se djemtë janë ata që e vazhdojnë sojin familjar, ata edhe janë më të fuqishëm se vajzat, çon në një dhënie përparësi shtesë të djemve mbi vajzat. Djali konsiderohet si personi që do t'i bartë përgjegjësitë materiale dhe shpirtërore të familjes, kur prindërit të plaken, e jo vajza. Nga ana tjetër, vajza perceptohet si një individ, nderi i së cilës duhet të mbrohet me çdo kusht nga meshkujt e familjes. Ky perceptim, ndërkaq, çon në dallimin e gjytimeve morale kur janë në pyetje meshkujt dhe femrat. Disa sjellje që nuk konsiderohen turp ose mëkat për djemtë, shihen si të papranueshme për vajzat, duke krijuar një sistem të dyfishtë moral, që i trajton vajzat si krijesa të dobëta, ndershmëria morale e të cilave duhet të mbrohet nga ana e burrave të shtëpisë. Për këto arsye,

shumë familje kanë dëshirë dhe mall të madh për të pasur djem, ndërsa vajzat renditen si të dytat në listën e dëshirave.

Një pikë thelbësore që shpesh nuk bie në sy lidhur me këto paragjykime që formohen dhe forcohen me kalimin e kohës, është se të dy fëmijët, edhe djemtë edhe vajzat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre i mësojnë nga familja dhe nga mjedisi përreth. Djemtë dhe vajzat rriten brenda kallëpeve (shabloneve) gjinore të përcaktuara nga shoqëria dhe i përmbushin rolet e tyre sipas mënyrës se si janë edukuar. Kështu, pas një periudhe të gjatë, bindjet lidhur me rolet gjinore forcohen si një litër i fortë, duke penguar kështu mendimin ndryshe dhe marrjen e roleve të tjera.

Kur i shikojmë paragjykimet që çojnë në mosdashjen e vajzave ose në renditjen e tyre në vend të dytë, bëhet e qartë se këto paragjykime janë prodhim i vetë shoqërisë. Edhe pse vajzat shpesh tregojnë më shumë interesim dhe kujdes për prindërit e tyre gjatë periudhës së pleqërisë, dhe përpiqen t'i plotësojnë nevojat e tyre si

dhe sillen ndaj tyre më me ndjeshmëri sesa djemtë, prapëseprapë djemtë vazhdojnë të perceptohen si garanci për periudhën e pleqërisë. Arsimimi i djemve për t'u bërë të aftë për punë dhe për t'u angazhuar në mbajtjen e familjes në të ardhmen, e forcon akoma më shumë këtë paragjykim dhe pritsshmëri shpesh të gabuar. Megjithatë, në këto vlerësime shpesh injorohet fakti se të drejtat për arsimim dhe punë për vajzat janë njohur si të barabarta vetëm në vitet e fundit. Kështu, ndarja e roleve nga familjet në përputhje me paragjykimet e tyre, e ka penguar krijimin e fuqisë ekonomike për vajzat, që do t'u lejonte atyre të ofronin mbështetje financiare për familjet e tyre kur është e nevojshme. Sigurisht, çështja se cilët fëmijë, djemtë apo vajzat, do t'u ofrojnë më shumë mbështetje dhe kujdes prindërve në periudhën e tyre të pleqërisë, lë të kuptohet vetëm me kalimin e kohës. Në qoftë se prindërit u sigurojnë mundësi të barabarta për arsimim dhe punë si djemve ashtu dhe vajzave, kjo do t'u mundësojë atyre të kenë gjithashtu pritshmëri të barabarta ndaj të

dyve për të ardhmen. Një sjellje e këtillë e prindërve është një nga parakushtet për ta ruajtur drejtësinë midis fëmijëve të tyre.

Edhe pse Kur'ani dhe Suneti i Pejgamberit a.s. nuk bëjnë dallim në lidhje me nderin, dëlirësinë dhe sjelljet morale, ekzistimi i bindjeve shoqërore për kritere të ndryshme lidhur me nderin dhe dëlirësinë për secilën gjini, flet mjaft për faktin se paragjykimet shoqërore formohen në mënyrë arbitrare. Për shembull, në Kur'an nuk ka dallim midis burrave dhe grave në sjelljet që konsiderohen si të turpshme ose si kurvëri (en-Nur, 24:2, 3, 26). Besimi se soji i familjes vazhdoet vetëm nëpërmjet djemve, është gjithashtu një produkt i paragjykimeve patriarkale. Soji i familjes vazhdoet nëpërmjet fëmijëve që lindin nga bashkimi i nënës dhe babait, pra i të dy gjinive. Me fjalë të tjera, vazhdimësia e sojit të çdo familjeje, në të vërtetë, sigurohet si nëpërmjet vajzave ashtu dhe nëpërmjet djemve.

Përveç kësaj, feja jonë e ndalon krijimin e ndonjë dallimi në vlera midis vajzave dhe djemve. Në Kur'an,

Allahu xh.sh. përmend se Ai i dhuron kujt të dojë vajzë e kujt të dojë djalë dhe se ky fakt, e fëmijët në përgjithësi janë një sprovë për prindërit. Ai thotë:

“Pushteti i qiejve dhe i tokës i takon vetëm Allahut. Ai krijon çfarëdo të dojë. Ai u jep vajza atyre që dëshiron, dhe djem atyre që dëshiron. Ose Ai u jep atyre çifte, djem dhe vajza, ndërsa e lë pa fëmijë (steril) kë të dojë. Me të vërtetë, Ai është i Dituri dhe i Fuqishmi.” (esh-Shu'ara, 42:49-50)

Kur'ani fisnik ia tërheq vërejtjen një prindi që ndihet i zemëruar kur i lind vajzë. Ai e dënon dhe e ndalon praktikën e varrimit për së gjalli të vajzave, një veprim që ndodhte në kohën e *xahilijetit* (periudhës para Islamit tek arabët). (et-Tekvir, 81:8-9; ez-Zuhruf, 43:17)

Disa paragjykime negative ndaj vajzave, si për shembull, besimi se djemtë janë të fuqishëm, të guximshëm dhe të zgjuar, ndërsa vajzat janë të dobëta, të ndrojtura dhe emocionale, është e njohur tanimë se e pengojnë shfaqjen e kapacitetit të vajzave dhe e frenojnë zhvillimin e aftësive të tyre.

Për shkak të këtyre paragjytimeve mund të thuhet se vajzat jetën e tyre e fillojnë një hap më mbrapa. Paragjykimet negative mund të çojnë në shkeljen e të drejtave, që vajzave duhet t'u njihen në mënyrë të barabartë me djemtë. Për shembull, vajzat mund të cilësohen si krijesa që nuk kanë nevojë për shkrim-lexim, duke i lënë kështu ato pa arsim të themelor. Është e njohur se këto praktika e frenojnë të ardhmen e vajzave, duke e penguar pjesëmarrjen e tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike. Si rezultat, këto ide dhe praktika e pengojnë mundësinë që vajzat të jenë modele efektive për bashkëmoshataret e tyre dhe e pamundësojnë krijimin e një imazhi të grave që mund të marrin pjesë aktivisht në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike.

Të rritesh i shoqëruar nga paragjykimet që nga fëmijëria, sjell disa pasoja negative edhe për djemtë. Ndarja e ashpër e roleve midis vajzave dhe djemve gjatë rritjes, në fakt u shkakton disavantazhe edhe djemve, duke mos u lejuar atyre të zhvillojnë aftësinë për të qenë të pavarur në të ardhmen. Një

djalë i rritur, i cili nuk ka arritur të aftësohet për plotësimin e nevojave të veta më themelore brenda shtëpisë, gjithmonë do të ketë nevojë për ndihmën e gruas, të vajzës ose të ndonjë kujdestareje tjetër. Sipas një shprehjeje të pranuar në shoqëri, “djali që nuk di të thyejë një vezë”, përfundon duke mbetur gjithmonë i varur nga ndihma e të tjerëve.

Duke qenë se sipas fesë sonë, si vajzat ashtu edhe djemtë janë një sprovim për prindërit, feja kërkon që të dyja gjinitë të trajtohen në mënyrë të barabartë gjatë këtij sprovimi. Meqë Allahu xh.sh. e ka bërë të qartë se asnjë veprim i besimtarëve, pavarësisht nga gjinia, nuk do të humbasë dhe se ata, në jetën e përtejme, do të shpërblehen sipas veprave të tyre (Alu Imran, 3:195; en-Nisa, 4:32, 124; el-Ahzab, 33:35; el-Mu'min, 40:40; el-Hadid, 57:12, 18; et-Teube, 9:72; en-Nahl, 16:97), kjo nënkupton se njerëzve edhe në provë duhet t'u njihen të drejtat e tyre të barabarta.

Vajzat dhe djemtë janë mirësi që Allahu xh.sh. i ka bërë burim gëzimi dhe lumturie dhe na ka lënë ne amanet.

Sjellja ndaj fëmijëve dhe masa e dashurisë dhe e mëshirës që u tregohet atyre, nuk duhet të përcaktohet nga gjinia. E drejta e asnjërit prej tyre nuk është më pak e vlefshme ose më pak e shenjtë se e tjetrit. Për këtë arsye, privimi i vajzave nga mundësitë për arsimim, edukim, punësim etj., bie në kundërshtim me parimet e fesë sonë.

Prandaj, nëse prindërit u japin vajzave ato mundësi materiale dhe shpirtërore sikurse djemve, dhe nëse djemve ua ofrojnë të njëjtat shkathtësi sikurse edhe vajzave, ata me këtë do t'i përmbushin kërkesat e drejtësisë brenda familjes, duke e parandaluar diskriminimin gjinor.

Identitete të reja, përgjegjësi të reja dhe gruaja si bashkëshorte

Problemet kryesore që kanë të bëjnë me gratë në jetën e përditshme më së shumti shfaqen në kontekstin e rolit të gruas si bashkëshorte. Gruaja që e merr përsipër këtë rol, ndodhet e rrethuar nga përgjegjësi të tilla si

nuse, bashkëshorte, nënë dhe amvisë e shtëpisë. Angazhimi më i madh i grave në punë jashtë shtëpisë, ka sjellë një librim relativ nga këto përgjegjësi, por, për shkak të pritshmërive shoqërore, rolet që një grua e martuar merr përsipër vazhdojnë ta rrethojnë atë me një peshë të rëndë përgjegjësie. Sigurisht, edhe kur burrat e marrin rolin e bashkëshortit, ata gjithashtu përballen me përgjegjësi të tilla si baba, bashkëshort, dhëndër, etj. Megjithatë, rolet brenda shtëpisë shpesh konsiderohen tradicionalisht si të lidhura me gratë, dhe detyrat biologjike si sjellja e fëmijëve në jetë dhe dhënia gji, lidhen natyrshëm me gratë, gjë që e rrit ndjeshëm edhe barrën e përgjegjësive për to në krahasim me burrat.

Në stilin e jetesës sistematike që e ka sjellë me vete modernizimi, nevoja për të kaluar disa orë të ditës në vendet e punës, si rezultat i logjikës së punës dhe prodhimit, kërkon që gratë të largohen pjesërisht nga rolet tradicionale që lidhen me amësinë. Në një farë mënyre, ato heqin dorë nga disa detyrime të nënës duke dërguar fëmijët e tyre në kopshte ose çerdhe. Kështu,

gratë si individë me karrierë, po shkëputen në një farë mase nga identiteti tradicional i gruas. Ky proces jo vetëm që hap fusha të reja përgjegjësish, por gjithashtu çon në ndryshimin e fushave ekzistuese të përgjegjësive. Për pasojë, vërehet se gratë po e ushtrojnë rolin e bashkëshorteve në kontekstin e identiteteve të reja dhe se ky ndryshim sjell me vete përgjegjësi të reja.

Bashkimi i një gruaje dhe një burri në një njësi familjare, që u jep atyre statusin e bashkëshortëve, sjell me vete jo vetëm bukuritë e jetesës në çift, por gjithashtu rrit edhe problemet dhe përgjegjësitë. Sipas bindjes së përgjithshme, problemet mes çifteve shfaqen më shumë në rastet kur nuk është arritur një barazim të mirë midis tyre. Çështje si statusi material-social, ndjenja e përkatësisë familjare, besimet fetare-tradicionale, barazia në arsim dhe tërheqja fizike mes partnerëve janë faktorë që ndikojnë në barazimin ose përafrimin midis tyre. Kur ka një barazim në këto aspekte, marrëdhëniet dhe rolet mes çifteve kanë më shumë mundësi të zgjidhen

në një terren kompromisi. Ky lloj barazimi mes partnerëve mund të quhet shkurtimisht “bashkimi i botëve”. Nëse për çfarëdo një arsye çiftet kaplohen nga ndjenjat se ata jetojnë në botë të ndryshme nga njëri-tjetri, kjo do të shkaktojë vështirësi në komunikimin mes tyre, duke e bërë të vështirë kështu edhe ruajtjen e bashkëjetesës dhe duke i lënë problemet brenda familjes të pa zgjidhura.

Në fenë tonë, kërkimi për barazinë ose ekuivalencën mes partnerëve (*kufv*) rekomandohet të bëhet para kërkesës për martesë. Para vlerave si prejardhja, bukuria dhe pasuria, zotërimi i etikës islame dhe ndjenja e përkatësisë fetare paraqiten si vlera më të rëndësishme që duhet të merren parasysh mes bashkëshortëve. Pejgamberi ynë (s.a.v.s.) e ka shprehur këtë me këto fjalë në një hadith:

“Dora e një gruaje kërkohet për katër gjëra: për pasurinë, për fisnikërinë, për bukurinë dhe për fenë. Ti zgjidhe atë që është fetare (e moralshme), në mënyrë që jeta juaj të jetë e begatë.” (Muslimi, “Rada”, 15)

Ekuivalenca mes partnerëve është e rëndësishme për vazhdimësinë e lumturisë familjare. Në Kur'an, partnerët përmenden si mbulesa njëri për tjetrin:

“Ato (gratë) janë mbulesa për ju, dhe ju (burra) jeni mbulesa për to.” (el-Be-kara, 2:187)

Shprehjet “të jesh mbulesë” në këtë ajet mund të kuptohen si shprehje figurative për afërsinë, mëshirën, solidaritetin, mbështetjen, barazinë, qetësinë dhe drejtësinë mes burrit dhe gruas. Nëse ka një harmoni të tillë mes partnerëve, ata do të mund të jenë vërtet “mbulesa” për njëri-tjetrin.

Kur gruaja bëhet nënë

Kur një grua bëhet nënë, në sytë e mjedisit familjar dhe shoqëror ajo vendoset në një pozitë shumë më të veçantë nga statuset dhe rolet e saj të tjera. Si në fenë tonë ashtu dhe në traditat dhe

zakonet tona, të qenit nënë është konsideruar si një pozitë e lartë.

Një ajet në Kur'an që trajton sjelljen ndaj prindërve, ai në të njëjtën kohë e thekson edhe rëndësinë e statusit të nënës:

“Zoti ju ka urdhëruar që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Tij dhe t’u bëni mirë prindërve. Nëse njëri prej tyre, ose të dy, arrijnë në moshën e pleqërisë pranë teje, mos u thuaj atyre ‘of’ dhe mos i qorto ata; folu atyre fjalë të mira. Ule për ta krahun e përulësisë nga mëshira dhe thuaj: ‘O Zoti im! Tregohu i mëshirshëm ndaj tyre, ashtu siç më rritën ata kur unë isha i vogël!’” (el-Isra, 17:23-24)

Pejgamberi ynë (s.a.v.s.) gjithashtu ka theksuar pozitën e larta të nënave duke thënë: *“Parajsa është nën këmbët e nënave.”* (Nesaiu, “Xhihad”, 6) Ai e ka përmendur nënën si personin e parë të cilit duhet t’i bëhet mirësi. (Buhariu, “Edeb”, 2)

Feja jonë e ka rekomanduar martesën, e ka nxitur krijimin i familjes si dhe e

ka ngritur nderin e të qenit nënë. Megjithatë, nëse një çift i martuar nuk ka fëmijë, kjo nuk konsiderohet si një arsye për shkurorëzim. Pamundësia për të pasur fëmijë në martesë duhet të vlerësohet si një sprovë. Kur'ani përmend pejgamberët Zekerija dhe Ibrahim, të cilët nuk kishin fëmijë deri vonë në pleqëri, dhe kjo paraqitet si një sprovë për ta (Merjem, 19:2-11; Hud, 11:71-73; el-Hixhër, 15:52-56).

Amësia (të qenit nënë), përveç se u jep grave një status të ndryshëm, gjithashtu u cakton atyre një rol të ri dhe zgjeron barrën e përgjegjësive të tyre. Nevojat biologjike të fëmijëve, si dhe shumica e nevojave sociale dhe psikologjike që kanë të bëjnë me rritjen dhe zhvillimin e tyre, përmbushen kryesisht nga nënat. Ndërsa në të kaluarën përcimi i vlerave tradicionale të fëmijët bëhej nga gjyshërit dhe gjyshet, sot kjo përgjegjësi është më shumë në duar të prindërve. Me kalimin nga modeli i familjes së zgjeruar në atë të familjes bërthamë, përgjegjësitë për të siguruar që fëmijët t'i mësojnë vlerat, zakonet dhe bindjet tradicionale, të marrin një arsim të

mirë dhe të zhvillohen si individë sociale, kanë kaluar gjithashtu në duar të prindërve.

Pjesëmarrja më aktive e grave në jetën sociale dhe ekonomike ka sjellë me vete disa diskutime rreth amësisë, e cila konsiderohet si detyra e tyre më themelore. Frika se gratë që punojnë mund t'i shpërfillin përgjegjësitë e tyre si nëna, ka bërë që shumë gra të ndihen emocionalisht të ngërthyera midis jetës profesionale (karrierës) dhe amësisë. Kjo situatë shpesh shndërrohet në një dilemë: “jeta profesionale apo amësia?”, duke i detyruar gratë ta zgjedhin njërin prej këtyre dyjave. Ndërkaq, ne konsiderojmë se amësia dhe jeta profesionale nuk janë alternativa të kundërta për njëra-tjetrën. Për t'u bërë një nënë e mirë dhe për të bërë punë cilësore, nuk kushtëzohet me sasinë e madhe të kohës që e ndanë për secilën prej tyre. Të qenit një nënë e mirë dhe një punonjëse e mirë njëkohësisht, realizohen kur këta individë veprojnë me vetëdije të lartë rreth përgjegjësisë të tyre. Individët që janë të vetëdijshëm për

përgjegjësitë e tyre mund t'i përmbushin kërkesat e jetës profesionale dhe të amësisë, duke u kushtuar kohë cilësore të dyja fushave.

Gruaja si objekt dhe subjekt i dhunës

Kur flitet për problemet e grave, një nga gjërat e para që vjen në mendje është dhuna që burri, i cili ka një forcë fizike më të madhe se ajo e grave, ushtron ndaj gruas - sidomos ndaj gruas si bashkeshorte. Në fillim, kuptimi që lidhet me “përdorimin e forcës fizike” është i dukshëm, por dhuna ka një kuptim më të gjerë. Përkufizimi i dhunës përfshin jo vetëm dhunën fizike, por edhe dhunën verbale dhe emocionale. Dhuna verbale dhe emocionale shfaqet përmes fjalëve ofenduese, si dhe përmes fjalëve që përmbajnë presion, si dhe me anë të gjesteve dhe mimikave që shprehin trysni. Dhuna nuk është vetëm një formë e presionit që burrat ushtrojnë ndaj grave, por gjithashtu ndodh edhe mes grave, si dhe mes prindërve dhe

fëmijëve dhe mes individëve të gjinisë dhe moshës së njëjtë. Në këtë rast, gruaja nuk është vetëm objekt i dhunës, por gjithashtu është edhe subjekt i saj. Nëse gruaja është një subjekt që ushtron dhunë, ajo kontribuon në vazhdimin e dhunës në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve.

Problemet më të dukshme në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve janë ato që shfaqen për nga jashtë nëpërmjet dhunës fizike. Në përgjithësi, dhuna perceptohet si një presion fizik nga i forti ndaj të dobët, por në të vërtetë, ajo është një tregues i dobësisë dhe produkt i një psikologjie të brishtë. Me fjalë të tjera, njerëzit që janë të fortë mendërisht dhe shpirtërisht, e njohin rëndësinë e komunikimit me anë të mendjes dhe shpirtit në marrëdhëniet e tyre dhe nuk përfshihen në përdorimin e forcës fizike.

Dhuna ndërmjet bashkëshortëve shfaqet, më së shumti, si rezultat i motivit për ta zotëruar dhe kontrolluar njëri-tjetrin gjatë periudhës para martesës, si dhe për shkak të dëshirës për ta vazhduar këtë kontroll edhe pas

lidhjes martesore. Kur kjo nuk është e mundur, ndjenja e dobësisë që lind nga pamundësia për ta realizuar idealin e menaxhimit të bashkëshortit/es, shfaqet si një reagim në formën e dhunës fizike.

Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve përfshijnë dhunën verbale që shfaqet përmes fjalëve poshtëruese, siç janë ofendimet dhe sharjet, ndërsa dhuna emocionale shfaqet përmes presionit shpirtëror, mosrespektimit të dëshirave dhe mendimeve të partnerit, si dhe nënçmimit përmes gjesteve dhe mimikave. Ndonjëherë, disa kërkesa të natyrshme (si p.sh. vizita e prindërve ose e të afërmve) ndalohen dhe marrin formën e vendimeve të prera.

Shpesh, dhuna ndërmjet bashkëshortëve shihet si një alternativë për të dyja palët, duke e anashkaluar me këtë rast dialogun reciprok dhe duke u konsideruar dhunën si një stil sjelljeje ose si një mënyrë për t'i zgjidhur problemet.

Në kontekstin e marrëdhënieve familjare, dhuna ndonjëherë shfaqet si

dhunë që gruaja ushtron ndaj personave të të njëjtës gjini. Për shembull, xhelozia dhe rivaliteti mes nuses dhe vjehrrës mund të shfaqen në forma dhune fizike, verbale ose emocionale. Përveç marrëdhënieve familjare, gratë gjithashtu mund të ushtrojnë dhunë edhe ndaj personave të së njëjtës gjini jashtë këtij rrethi, qoftë ajo dhunë fizike, qoftë verbale apo emocionale.

Një tjetër fushë ku shfaqet dhuna brenda familjes është edhe ajo në raport të prindërve me fëmijët gjatë rritjes së tyre. Pavarësisht dhembshurisë së madhe të prindërve, dhuna që ata ushtrojnë ndaj fëmijëve shpesh shfaqet kur ata kanë vështirësi në kontrollimin e nervave të tyre. Megjithatë, mendimi se ata nuk mund t'i kontrollojnë nervat e tyre është më shumë një arsyetim, veshje të dhunës me petk të aryes, sesa një shpjegim për të. Kjo më së shpeshti ndodh kur dëshirat dhe pritshmëritë e prindërve bien ndesh me ato të fëmijëve, dhe kur ata u japin përparësi dëshirave të tyre, gjë që rezulton në ushtrimin e dhunës ndaj fëmijëve.

Një dimension tragjik i dhunës brenda marrëdhënieve të bashkëshortëve është kur fëmijët janë dëshmitarë të skenave të dhunës. Sipas hulumtimeve, fëmijët shpesh janë dëshmitarë të dhunës verbale ose fizike që ndodh mes prindërve. Duke qenë dëshmitarë të këtij lloji dhune, fëmijët i nënshtrohen një eksperience dhune që është e pamundur të riparohet ose harrohet në të ardhmen. Për më tepër, këto eksperiencia mund të lënë ndikime edhe më të këqija në imagjinatën e fëmijëve, sesa ato që ata vetë i përjetojnë. Duke e përjetuar një atmosferë dhune, fëmijët mund ta shohin dhunën si një alternativë dhe ta adoptojnë atë si një stil sjelljeje.

Feja jonë thekson se si për gratë ashtu edhe për burrat, frika nga Allahu xh.sh. dhe vetëdija për llogaridhënien ndaj Tij duhet të jenë të pranishme në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin dhe me rrethin ku jetojnë. Kjo nënkupton se çdo veprim, fjalë dhe qëndrim i tyre duhet të jetë i matur dhe i kujdesshëm.

Feja jonë, e cila gratë dhe burrat i cilëson si individë të barabartë para

Zotit, marrëdhëniet midis tyre i vlerësohen në kontekstin e dashurisë, të afërsisë emocionale dhe të dhembshurisë dhe thekson se çiftet ndaj njëri-tjetrit kanë të drejta dhe përgjegjësi. Kështu në Kur'an, ekzistenca e dashurisë dhe e dhembshurisë në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, prezantohet si provë për ekzistencën e Zotit:

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje te ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (er-Rum, 30:21)

Nëse e shqyrtojmë jetën e Pejgamberit s.a.v.s., do të shohim se ai nuk ka ushtruar asnjëherë dhunë, as fizike dhe as verbale, ndaj grave, fëmijëve apo ndonjë krijese tjetër. Përkundrazi, për këtë dimension të jetë së tij, bashkëshortja Aisheja r.a. tregon se:

“Pejgamberi nuk ka godur kurrë asnjë gjë me dorë, asnjë grua e as një shërbëtor/e.” (Muslimi, “Fedail”, 79;

Ibnu Maxhe, "Nikah", 51; Darimiu, "Nikah", 34)

Pejgamberi gjithashtu ka paralajmëruar burrat në lidhje me sjelljen ndaj grave dhe i ka inkurajuar ata të jenë të kujdesshëm dhe të sjellshëm në raport me to:

"Më të mirët nga besimtarët, në aspektin e besimit, janë ata që kanë moralin më të bukur. Po ashtu, më të mirët tuaj janë ata që i trajtojnë më mirë gratë e tyre." (Tirmidhiu, "Rada", 11)

Dhuna, qoftë ajo verbale, fizike apo emocionale, shpesh buron nga dhënia përparësi dëshirave personale kur ato përplasen me ato të të tjerëve - siç janë bashkëshorti apo fëmijët. Pengimin e kësaj mund ta bëjmë vetëm duke u mbështetur në parimet morale të fesë tonë. Sipas këtyre parimeve morale, njeriu merr shpërblim dhe e afron vetveten më shumë te Allahu xh.sh. jo me egoizëm, porse me gatishmëri për të flijuar; jo me kryelartësi, por me modesti; jo me koprraci, por me bujari; jo me vrazhdësi, por me respekt; jo me egërsi, por me butësi e

delikatesë; jo me zemërim, por me mëshirë e dhembshuri.

Gruaja midis traditave dhe vlerave bashkëkohore

Shprehja “krimet për shkak të traditës” ka filluar të dëgjohet më shpesh në kohët e fundit, dhe fjala “traditë” sot ka marrë më shumë kuptim negativ. “Tradita” në thelb ka kuptime të ngjashme me “zakonet, normat, adetet dhe doket” dhe nuk nënkupton domosdoshmërisht një të keqe ose nuk i hap rrugën të keqes. Shumë praktika, nga lindja e fëmijëve dhe rritja e tyre deri te ceremonitë e varrimit, janë të pranishme në pothuajse çdo fazë të jetës dhe vazhdojnë të mbijetojnë përmes përcaktimeve të traditave, duke funksionuar si një element që e mban shoqërinë të bashkuar.

Në procesin e ndryshimeve shoqërore, përpjekjet për të ruajtur traditat me një qëndrim të ngurtë që e shtyp plotësisht rezistencën e brezit të ri,

padyshim që mund të çojnë në tensi-
one dhe probleme shoqërore. Ky feno-
men është i dukshëm në çdo lloj për-
plasje mes “të vjetrës dhe së resë” apo
“tradicionales dhe bashkëkohores”.
Një tradicionalizëm i ngurtë që nuk e
merr parasysh dinamikën, duke qenë
se nuk është në gjendje të pranojë
mendime dhe kuptime të reja, si dhe
duke qenë jo tolerant ndaj dëshirave
dhe qëndrimeve bashkëkohore, ai
mund të përfundojë me thyerje që do
ta dëmtojnë edhe vetë rrjedhën e tra-
ditës. Në mënyrë të ngjashme, një
qëndrim që i mohon dhe i nënçmon
traditat dhe zakonet, duke i mohuar
lidhjet e njerëzve me të kaluarën e tyre
mund të çojë në përjetimin e një krize
identiteti nga ana e tyre. Për të sigu-
ruar që vlerat tradicionale të mos e
humbin dinamizmin e tyre dhe të
përfshijnë kuptime të reja në gjirin e
vet, është e nevojshme që njerëzit të
vetëdijeshohen dhe të edukohen sa me
traditat e tyre, po aq edhe me vlerat
bashkëkohore.

Është e rëndësishme që gratë të fitojnë
një motivim për të zhvilluar një
vetëdije që i sodit dhe i kupton sa

traditat po aq dhe vlerat bashkëkohore. Ato duhet të kenë një vetëdije që ua mundëson atyre t'i sodisin dhe vlerësojnë si traditat ashtu edhe vlerat bashkëkohore, duke përcaktuar dhe zgjedhur vetë se çfarë është e mira, e drejta dhe e bukura për to dhe për shoqërinë ku jetojnë. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet çlirimit të vetëdijes së grave në rrugën drejt kuptimit të vlerave tradicionale dhe bashkëkohore.

Traditat nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht një ecuri tradicionale negative që është krejtësisht e dëmshme për gratë. Megjithatë, kur traditat e caktuara bëhen statike pa u soditur dhe pa u shqyrtuar, ato perceptohen si një situatë negative si nga ana e botëkuptimeve humaniste ashtu dhe nga parimet fetare. Sepse një situatë e këtillë e injoron dinamikën e strukturave shoqërore dhe mund të lejojë që praktikrat e padrejta të vazhdojnë të jetojnë.

Feja jonë i ka hedhur poshtë praktikrat e padrejta që nuk janë në favor të grave, edhe pse ato mund të kenë një validitet dhe pranim shoqëror. Kështu,

traditat ose zakonet lokale kanë marrë një rrjedhë të ndryshme. Një shembull i këtij ndryshimi është ndalimi me Kur'an i praktikës që pas vdekjes së bashkëshortit, gruaja e vejë të trashëgohet nga thjeshtri (djali i burrit nga martesë e tij e parë). Ajeti kur'anor *“O besimtarë, nuk është e lejuar t'i merrni gratë (e baballarëve tuaj të vdekur) si trashëgim në mënyrë të dhunshme...”* (en-Nisa 4:19) na njofton për ndalimin e një praktike që asokohe e shkilte me këmbë dinjitetin e grave.

Një nga manifestimet më ekstreme të dhunës ndaj grave janë krimet e motivuara nga tradita dhe nga konceptimi i nderit. Sipas kësaj, edhe pse nderi, besnikëria dhe pastërtia morale janë koncepte më gjithëpërfshirëse, ato lidhen në mënyrë të gabuar vetëm me trupin e gruas dhe shihen, prapë gabimisht, si vlera për të cilat përgjegjëse janë vetëm gratë.

Traditat kanë një logjikë të brendshme që synon mbrojtjen e të dyja gjinive, por kjo logjikë mund të përfundojë në abuzime dhe padrejtësi me kalimin e kohës. Parimet dhe mësimet fetare, të cilat për qëllim kanë vendosjen e

drejtësisë, kërkojnë që rrethanat të cilat çojnë në padrejtësi shoqërore të eliminohen tërësisht.

Feja jonë, duke qenë se e merr në konsideratë dinjitetin e të dyja gjinive, si të burrit ashtu edhe të gruas, në çështjet si martesë, divorci dhe trashëgimia, kërkon që për bazë të merret pëlqimi i individëve apo i palëve. Për shembull, kërkitimi i “parave të dhëndrit” (që familja e dhëndrit ia paguan familjes së nuses para martesës) është një praktikë që feja nuk e mbështet. Po ashtu, detyrimi i gruas që të martohet me vëllanë e bashkëshortit të saj të ndjerë është një tjetër praktikë që feja nuk e miraton. Në fenë tonë nuk tolerohet pengimi i martesës së dy individëve që duan ta bëjnë këtë me pëlqim të dyanshëm, por as edhe të detyrohen për një martesë që ata nuk e pëlqejnë. Po ashtu, të ndaluara janë edhe vrasjet që bëhen kinse për ta mbrojtur dhe ruajtur ndërin apo „fytyrën“ e familjes.

Fjala e Zotit na inkurajon ta ruajmë jetën, e jo të vrasim. Kur’ani i Famsëm thotë: *“Kush vret një njeri pa arsye (si hakmarrje) është si të ketë vvarë të*

gjithë njerëzimin. Kush shpëton një jetë, është si të ketë shpëtuar të gjithë njerëzimin...” (el-Maideh, 5:32). Ky ajet nënvizon sa e rëndë është vrasja në sytë e Zotit dhe sa e rëndësishme dhe e bukur është garantimi i jetës.

Arsimimi dhe gruaja

Perceptimi i një shoqërie të zhvilluar dhe të fuqishme është ngushtësisht i lidhur me nivelin e dijes dhe edukimit të individëve në atë shoqëri. Sot, është e njohur se problemet që renditen nën rubrikën “problemet e grave”, lidhen në thelb me nivelin e ulët të edukimit.

Në vendin tonë (në Turqi), përqindja e grave analfabete është më e lartë se ajo e burrave. Sipas të dhënave, në rajonin e Marmarasë, 13.1% e grave janë analfabete, ndërsa në Rajonin e Juglindjes, 46.3% e grave nuk dinë të lexojnë e të shkruajnë. Krahasuar me vendet e zhvilluara, përqindja e grave që dinë të lexojnë e të shkruajnë dhe që kanë përfunduar arsimin e lartë është shumë e ulët.

Një nga arsyet e prapambetjes në edukimin e grave është paragjykimi i përhapur që pengon shkollimin e vajzave. Po ashtu, nëse kushtet ekonomike nuk janë të përshtatshme, shpesh preferohet të dërgohen në shkollë djemtë në vend të vajzave. Megjithatë, feja jonë e detyron çdo musliman, mashkull apo femër, të mësojë, siç theksohet në hadithin e Muhamedit s.a.v.s., ku thuhet se *“Mësimi (kërkimi i dijes) është obligim për çdo musliman”* (Ibnu Maxhe, “Mukaddime”, 17), dhe rekomandon që dija të merret, pavarësisht se ku ndodhet ajo (Tirmidhiu, “Ilm”, 19). Po ashtu, Kur’ani thekson se ata që dinë dhe ata që nuk dinë nuk janë të barabartë (ez-Zumer, 39:9).

Mos arsimit i vajzave në moshë të re ndikon në mënyrë negative në statusin e tyre socio-ekonomik në të ardhmen. Gjithashtu, kjo i çon ato në një situatë ku ato të heqin dorë nga sfera publike dhe të izoloohen vetëm në sferën private. Përveç kësaj, mungesa e edukimit ose edukimi vetëm në nivelin fillestar, shkakton që vetëdija e grave të jetë e mbyllur ndaj historisë

së saj. Si rezultat i kësaj gjendjeje, gratë nuk arrijnë të ndikojnë mjaftueshëm në histori. Gratë që nuk mund të ndërhyjnë në histori, pashmangshëm përfundojnë të bëhen objekte pasive të historisë, në vend që të bëhen subjekte aktive të saj.

Thënë përmbledhtas, mungesa e edukimit, me kalimin e kohës, shndërrohet në një grackë që vendos gratë nën një formë të plotë të skllavërisë në jetën e tyre. Prandaj, ka përgjegjësi të ndryshme për secilin nga ne për të siguruar që vajzat dhe gratë të shkollohen, të edukohen dhe të zhvillohen si duhet.

Vlerat universale dhe gruaja

Sot, me pjesëmarrjen e shumë institucioneve ndërkombëtare, zyrtare dhe civile, po bëhen përpjekje për përmirësimin e të drejtave të grave, si dhe për të krijuar institucione shoqërore më të ndjeshme ndaj shkeljeve të të drejtave të grave.

Megjithatë, vlerat që gratë mund t'ia dhurojnë njerëzimit, nuk kanë arritur të shprehen dhe të zbatohen plotësisht për shkak të paragjykimeve që vazhdojnë të jenë të pranishme në shumë shoqëri.

Me hapjen dhe zgjerimin e fushëveprimit të grave, si pasojë e rritjes së ndjeshmërisë në lidhje me të drejtat e grave, ato i presin sa liritë po aq edhe përgjegjësitë. Pyetja se çfarë filozofie dhe çfarë zbatimi të asaj filozofie do të prodhojnë gratë për shoqëritë ku jetojnë në nivelin lokal dhe për mbarë njerëzimin në nivelin global, mbetet pa përgjigje. Megjithëkëtë, është e rëndësishme të theksojmë se sot gratë kanë një ideal për të kontribuar në prodhimin dhe jetësimin e vlerave universale, dhe kjo duhet të shihet si një fitore më vete.